

Njoftim-KRITERET E PËRFITIMIT TË BURSËS PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022

Në mbështetje të VKM-së nr 666 datë 10.10.2019” Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, i ndryshuar për vitin shkollor 2021-2022”, Bashkia Maliq njofton të gjithë nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike do përfitojnë bursë në përputhje me kuotat dhe kriteret e vendosura nga qeveria.

Dokumentacioni i nevojshëm për përfitim burse për vitin shkollor 2021-2022:

Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet publike përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve si më poshtë vijon:

2.1 Sipas kriterit ekonomik

(a) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që akomodohen në konvikte publike;

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari për aplikim burse
- Vertetim nga shkolla, për regjistrimin përfundimtar në degën përkatëse në vitin shkollor 2021-2022
- Vertetim nga Drejtoria e Konviktit ku është i akomoduar
- Çertifikatë familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Vertetimet përkatëse për secilën nga të ardhurat që deklarohen nga kryefamiljari
- Vertetim për vlerën e ndihmës ekonomike kur familja e përfiton ose jo. Numri i dosjes, masa e plotë ose e pjesshme dhe shuma (Sektor i Ndihmës Ekonomike të firmosur nga P/Nd/ekonomike dhe Kryetari i njësisë).
- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore ku të jetë e përcaktuar nëse prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes mbi moshën 18 vjeç marrin ose jo pension dhe shtesa të tjera (Zyra e Sigurimeve Shoqërore).Vertetim pensioni për prindërit që kanë statusin e invalidi
- Vertetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve për të gjithë anëtarët e familjes mbi moshën 18 vjeç, ushtrojnë ose jo aktivitet privat.
- Vertetim nga shkollat në rastet kur në familje ka nxënës në shkollë të mesme apo student që verteton se trajtohen ose jo me bursë.
- Vertetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vertetim nga Zyra e Punës për të gjithë pjestarët e familjes në moshën e punës që janë kërkues pune dhe nuk trajtohen me asistencë sociale.
- Vertetim nga Zyra e Kadastrës që disponon ose jo tokë bujqësore për të dy prindërit, në rastin që disponon të jetë e përcaktuar në m2 dhe të ardhura totale që përfitojnë prej saj.
- Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që disponon ose jo pronë për të dy

prindërit (shtëpi, dyqan, lokal etj).

(b) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brënda rrëzes prej 5 km, të cilët plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, dhe që akomodohen në konvikte publike.

Dokumente që do të paraqesin janë njësoj si në pikën (a)

(c) të gjithë nxënësit që i përkasin kategorisë nxënës të familjeve në nevojë me ndikim në uljen e nivelit të braktisjes shkollore që janë të regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare nuk e ndjekin arsimin, përfitojnë bursë pas konfirmimit nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, të listës emërore të kësaj kategorie.

2.2 Sipas rezultateve të arritura

Të gjithë nxënësit që i përkasin kategorisë nxënës dhe përfitojnë bursë sipas rezultateve të arritura, nxënësit e arsimit profesional që kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me notën mesatare 9 (nëntë)-10 (dhjetë)

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari për aplikim burse
- Vërtetim nga shkolla, për regjistrimin përfundimtar në degën përkatëse në vitin shkollor 2021-2022
- Çertifikatë familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Kopje të deftesës dhe vërtetim nga shkolla për mesataren e vitit paraardhës.

2.3 Nxënësit jashtë kriterit ekonomik

Të gjithë nxënësit që i përkasin kategorive sipas pikës 2.3 të VKM nr 666 datë 10.10.2019” si vijon:

(a)nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit;

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi për përfitim burse.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi, në cilën dëgë dhe në cilin vit shkollor është.
- Nxënësit me statusin e jetimit duhet të paraqesin statusin ose fotokopje e noterizuar të këtij statusi të përfituar nga Shërbimi Social Shtetëror pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale

- Çertifikatë familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Çertifikatën e vdekjes së të dy prindërve

(b) nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi për përfitim burse.
- Çertifikatë familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi, në cilën

degë dhe në cilin vit shkollor është.

- Nxënësi që ka humbur kujdestarinë prindërore të dorëzoj vendimin e gjykatës së formës së prerë të humbjes së kujdestarisë nga të dy prindërit, nga (Gjykata e Rrethit).

(c) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik;

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari drejtuar shkollës së mesme për përfitim burse.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Çertifikatë familjare e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi, në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është.
- Vërtetim origjinal ose fotokopje e noterizuar të lëshuar nga KMCAP(Komisioni Mjeksor i Caktimit të Aftësisë për Punë)për nxënësin me aftësi të kufizuar.
- Vërtetimi për pagesën e aftësisë së kufizuar të lëshuar nga zyra përkatëse.

(ç) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari për përfitim burse.
- Çertifikate familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi, në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është.
- Vertetim origjinal ose fotokopje e noterizuar te leshuar nga KMCAP(Komisioni Mjeksor i Caktimit te Aftesise per Punë)per nxenesin me aftesi te kufizuar.
- Vertetimi për pagesën e aftësisë së kufizuar të lëshuar nga zyra përkatëse.

(d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit;

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari për përfitim burse.
- Çertifikate familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi, në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është.
- Vertetim origjinal ose fotokopje e noterizuar te leshuar nga KMCAP(Komisioni Mjeksor i Caktimit te Aftesise për Punë)per prindin me aftesi te kufizuar.
- Vertetimi për pagesën e aftësisë së kufizuar të lëshuar nga zyra përkatëse.

(dh) nxënësit e pakicës kombëtare rrome dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari për përfitim burse.
- Çertifikate familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.

- Vertetim nga shoqata e Romëve.
 - Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi,në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është.
- (e) nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi për përfitim burse.
- Çertifikate familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi,në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është.
- Vendim gjykate i formës së prerë që kanë humbur kujdesin prindëror.
- Vërtetim nga Ministria e Brendshme që janë trajtuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror.

(ë) nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari për përfitim burse
- Çertifikate familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi,në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është.
- Çertifikate vdekje të prindit që ka rënë në krye të detyrës.
- Vërtetim nga Ministria përkatëse që vërteton këtë status.

(f) nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimit mësimore mekanikë, elektroteknikë, elektronikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë;

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësja apo kryefamiljari për përfitim burse
- Çertifikate familjare e nxënëses.
- Çertifikatë personale e nxënëses.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi,në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është.

(g) nxënësit me një prind.

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari për përfitim burse.
- Çertifikate familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi,në cilën

degë dhe në cilin vit shkollor është.

- Çertifikate vdekje të prindit.

2.4 sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm

(a) nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional në drejtimit mësimore bujqësi, veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji- miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit;

(b) nxënësit me vendbanim të përhershëm në Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Skrapar dhe Tepelenë.

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari për përfitim burse.
- Çertifikate familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi, në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është.

3. Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur:

- janë ndarë nga trangu familjar;
- familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;
- deklarohen mbetës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalueuse

4.Nxënësit të cilët kanë përfituar Bursë në vitin e parë (klasa 10), me Vendim të Këshillit Bashkiak ku ato kanë vendbanimin e përhershëm të cilëve nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës, përfitojnë bursë.

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari për aplikim burse
- Vertetim nga shkolla, për regjistrimin përfundimtar në degën përkatëse në vitin shkollor 2021-2022 dhe që nuk është ngelës në vitin paraardhës
- Vertetim nga Drejtoria e Konviktit ku është i akomoduar
- Çertifikatë familjare e nxënësit.
- Çertifikatë personale e nxënësit.
- Vertetimet përkatëse për secilën nga të ardhurat që deklarohen nga kryefamiljari
- Vertetim për vlerën e ndihmës ekonomike kur familja e përfiton ose jo. Numri i dosjes, masa e plotë ose e pjesshme dhe shuma (Sektor i Ndihmës Ekonomike të firmosur nga P/Nd/ekonomike dhe Kryetari i njësisë).
- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore ku të jetë e përcaktuar nëse prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes mbi moshën 18 vjeç marrin ose jo pension dhe shtesa të tjera (Zyra e Sigurimeve Shoqërore). Vertetim pensioni për prindërit që kanë statusin e invalidit
- Vertetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve për të gjithë anëtarët e familjes mbi moshën 18 vjeç, ushtrojnë ose jo aktivitet privat.
- Vertetim nga shkollat në rastet kur në familje ka nxënës në shkollë të mesme apo student që verteton se trajtohen ose jo me bursë.

- Vertetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
- Vertetim nga Zyra e Punës për të gjithë pjestarët e familjes në moshën e punës që janë kërkues pune dhe nuk trajtohen me asistencë sociale.
- Vertetim nga Zyra e Kadastrës që disponon ose jo tokë bujqësore për të dy prindërit, në rastin që disponon të jetë e përcaktuar në m2 dhe të ardhura totale që përfitojnë prej saj.
- Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që disponon ose jo pronë për të dy prindërit (shtëpi,dyqan,lokal etj).

5.Nxënësit e shkollave profesionale të cilët ndjekin vitin e dytë në drejtimet mësimore: bujqësi veterinar, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim të vendburimeve të gazit dhe naftës, dhe nxënëset vajza të cilët kanë përfituar bursë vitin e parë dhe në vitin shkollor paraardhës nuk rezultojnë mbetës, përfitojnë bursë.

Dokumente që do të paraqesin:

- Kërkesë nga nxënësi apo kryefamiljari për përfitim burse.
 - Çertifikate familjare e nxënësit.
 - Çertifikatë personale e nxënësit.
 - Vërtetim banimi nga njësia e vetqeverisjes vendore ku banon nxënësi.
 - Vërtetim nga sekretaria e shkollës ku është regjistruar dhe vazhdon studimet nxënësi,në cilën degë dhe në cilin vit shkollor është dhe nuk është ngelës në vitin paraardhës shkollor.
- Dorëzimi i dokumentacionit të mësipërm, nga nxënësit/prindërit dhe drejtoritë /komisionet e shkollave, sipas kriterëve përfituese, ku nxënësit studiojnë të dorëzohet pranë sekretarive të shkollave, zyrave me Një Ndalesë të Njësisive Administrative, të Bashkisë Maliq deri më datën **31.10.2021**.

SHENIM: Dokumente që do të paraqiten do të dokumentohen nga instancat përkatëse me dokumentacion original apo kopio të noterizuara.